



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-MZB2-4066
Datë: 21.01.2025

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 35 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në Qendrën për Punë Sociale, me datë 21.01.2025 mori këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësi **Dervish Tahiri**, i sistemuar në punë Udhëheqës i Sektorit për Regjistrimin e Bizneseve në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik, **caktohet edhe ushtrues i detyrës së Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale**, që të punoj me kompetenca të plota, sipas koeficientit **7.26** (GJ3) duke filluar nga data **03.02.2025** deri në zgjedhjen e drejtorit të ri përmes procedurave të pranimit/rekrutimit.
2. I emëruari si në piken 1 të këtij vendimi, ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si më poshtë:
 - 2.1. Udhëheqë punën e përgjithshme të qendrës për punë sociale, cakton objektivat dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave si dhe harton planin e punës.
 - 2.2. Menaxhon stafin e qendrës për punë sociale dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek vartësit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit.
 - 2.3. Bën vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe inicon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës.
 - 2.4. Kontribuon në procesin e vendimmarrjes, sipas fushës së përgjegjësisë duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analiza të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes.
 - 2.5. Përcjellë nevojat sociale në mënyrë që të caktohen prioritetet e punës dhe që të sigurohet asistencë dhe shërbimet sociale duke përfshirë të gjithë qytetarët e në veçanti personat me nevoja të veçanta.
 - 2.6. Siguron koordinimin e aktiviteteve me njësitë e tjera organizative të Komunës së Gjakovës për të siguruar efikasitet dhe zbatim të drejtë të proceseve të punës.
 - 2.7. Udhëzon stafin në përmbushjen e aktiviteteve të përditshme dhe siguron që kjo veprimtari të jetë në përputhje me legjislacionin, politikat institucionale dhe standardet përkatëse.
 - 2.8. Siguron komunikimin brenda dhe jashtë njësisë organizative dhe institucionit me qëllim të mbledhjes ose shkëmbimit të informacionit.
 - 2.9. Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerjen e detyrave në përputhje me standardet e kërkuara.
3. Zyrтари publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar. Çdo vendim i marrë nga ushtruesi i detyrës pas kalimit të afatit të përcaktuar është i paligjshëm.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

- Vendimi iu dorëzohet:**
- Nëpunësit Dervish Tahiri
 - Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
 - Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
 - Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
 - Arkivit

Ardian Gjini

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

